



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:255498

Datë: 04.09.2024

Numri i dokumentit: 06121582

C-IV-23-0647

Paditësi; R V, përfaqësuar nga avokati B I nga Prishtina.

Kundër

Pala e paditur: NSH Ingeniering e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishtë-Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përmes gjyqtarit Asllan Krasniqi, me datën; 02.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e parashtruar nga R V.

1. Detyrohet e paditura që t'ia kompensoj shumën prej; 2.534.00 euro (neto), në emër të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënjes së punës së paditësit për gjashtë paga të papaguara të cilat llogaritur në shumën prej 362.00 euro (neto) për çdo muaj, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 10%, në shumën prej; 253,40 euro, sipas prioriteteve të kërkesave.

2. Detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore ti paguaj palës paditëse shumën prej; 489.00 euro.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 19.06.2014 pranë DHPGJS është parashtruar padi grupore kundër të të paditurës NSH Ingeniering e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në lidhje me vendimin me numër PRN-129-0006 të datës; 15.05.2014, ndërsa me datën; 21.04.2020 ka bërë rregullimin e padisë duke kundërshtuar vendimin që evidentohet me shenjën PRN-129-0005 të datës 27.05.2014, me të cilin i është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për kompensimin e shumës prej 21.297.29 €, në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje para kohe të marrëdhënies së punës në Ndërmarrjen Shoqërore Ingeniering (në likuidim).

Kolegji i Apelit me datën; 21.11.2023 kishte kthyer lëndën në rigjykim me pretendim se kërkesa e palës paditëse lidhur me ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënjes së punës nuk është e

parashkruar dhe për këtë arsye me caktimin e një seance dëgjimore do të sqaroheshin pretendimet e palëve ndërgjyqëse lidhur çështjen e parashkrimit dhe shumat e pretenduara për ndërprerjen e marrëdhënjes së parakohshme të punës së paditësit R V.

Në seancën e mbajtur me datën;16.07.2024 pala paditëse ka mbetur në tërësi pranë pretendimit të tij lidhur me kompensimin e të ardhurave personale për gjashtë muaj në emër të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënjes së punës si pasojë e likuidimit të ndërmarrjes në vitin 2009 për të cilin e dokumenton me shkresën e datës;14.01.2009 me të cilën vërtetohet se pagat e që u janë borgj do të mbesin si përgjegjësi e punëdhënësit,që në rastin konkret është NSH Ingeniering e cila admnistrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit,andaj përfundimisht i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadsisë së paditësit si të bazuar dhe kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Në fjalën e tij përfundimtare të hartuar me shkrim i autorizuari i palës paditëse ka sqaruar faktin se objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike kontestimore është vendimi i cili evidentohet me shenjën PRN-129-0006 i datës;15.05.2014 që ka të bëjë me kompensimin e shumës prej;27.750.00 euro,mirëpo duke ndryshuar pretendimin e tij lidhur me shumën e kërkuar pasiqë sipas tij shuma lidhur me ndërprerjen e marrëdhënjes së punës së parakohshme prej gjashtë konsiston në shumën reale prej;2.534.00 euro,sepse shuma mujore neto ka qenë 362.00 euro,andaj duke shumëzuar këtë shumë për gjashtë muaj është e barazvlefshme me shumën e përgjithshme prej;2.534.00 euro.

E paditura në seancën e mbajtur me datën;16.07.2024 në përgjigjen në padi si dhe në fjalën përfundimtare të hartuar me shkrim të datës;02.08.2024 ka mbetur në tërësi pranë kundërshtimeve të tij duke pretenduar se pala paditëse me asnjë provë nuk ka provuar dhe dokumentuar për të mundësuar të njëjtit përfshirjen e kërkesës së tij në fushëveprimin e Autoritetit të Likuidimit,andaj edhe përfundimisht i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësit si të pabazuar.

Kësaj padie parashtruesi si provë i ka bashkëngjitur:

- *Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN-129-0005, me të cilin i është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim.*
- *Shkresa e datës;14.01.2009*
- *Librezën e punës*
- *Lista e punëtorëve lidhur me pagesat e tyre bruto*

Arsyetimi Ligjor

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar

Nga provat e shqyrtuara po ashtu nga pretendimet dhe parashtrimet e palëve në procedurë gjykata ka gjetur se NSH Ingeniering ka hyrë në procedurë të likuidimit me datën;14.01.2009,andaj edhe më këtë rast iu është ndërprerë marrëdhënje e punës të gjithë punëtorëve të cilët kanë qenë të punësuar në këtë ndërmarrje shoqërore e cila vërtetohet nga shkresa e datës;14.01.2009 e cila iu është shpërndarë të gjithë punëtorëve të cilëve edhe iu është ndërprerë marrëdhënje e punës.

Shkresa e datës;14.01.2009 e dorëzuar nga i autorizuari i palës paditëse me të cilën vërtetohet se e paditura ka marrë përgjegjësi lidhur me borgjet ndaj punëtorëve të cilëve iu është ndërprerë para kohe marrëdhënja e punës për gjykatën paraqet provë bindëse se nuk kemi parashkrim të kërkesës,gjegjësisht në rastin konkret kemi ndërprerje të parashkrimit sipas kësaj shkrese,andaj edhe ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Ndërsa gjykata ka aprovuar pretendimin e palës paditëse për shumën prej;2.534.00 euro llogaritur në pagesë neto duke u bazuar në shkresën gjegjësisht në listën e hartuar nga e paditura për pagesat e punëtorëve,në të cilën listë gjindet edhe emri i paditësit.

Kamata ligjore prej 10 % është bazuar në dispozitën e nenit 37 paragrafi 3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,ka aprovuar shumën e përgjithshme prej;489.00 euro,prej të cilave gjykata ka aprovuar shumën prej;104.00 euro në emër të hartimit të padisë,shumën prej;208.00 euro në emër të ushtrimit të ankesës ndaj aktgjykimit të shkallës së parë,shumën prej;135.00 euro në emër të përfaqësimit në seancën dëgjimore të datës;16.07.2024,shumën prej;21.00 euro në emër të pagesës së taksës gjyqësore si dhe shumën prej;21.00 euro në emër të ankesës së ushtruar në shkallën e dytë,ndërsa ka refuzuar si të pabazuar shumat prej;52.00 euro,në emër të kërkesës ndaj Autoritetit të Likuidimit dhe shumën prej;21.00 euro në emër të shqyrtimit të shkresave të lëndës të cilat nuk kanë bazë për aprovim.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim, duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ,brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari;
Asllan Krasniqi